

ANALYSIS OF PROPOSAL NEW CONCEPT FOR PRIMARY EDUCATION - A NEW APPROACH TO THIS EDUCATION CYCLE

Havushe Rexhepi

University of Tetovo, Faculty of Pedagogy, R.N. Macedonia, havushe.rexhepi@unite.edu.mk

Rabije Murati

University of Tetovo, Faculty of Pedagogy, R.N. Macedonia, rabije.murati@unite.edu.mk

Abstract: Education today is a very important problem all over the world, as well as in our country, so its reform is the main intention of the leaders of this digester.

Education reforms have started to be implemented in previous years and continue to be relevant today because quality and success depend on these reforms. In relation to this issue, the Concept for primary education has been drafted, according to which a contemporary approach to learning is provided.

This paper aims to analyze the Concept and verify how much its content actually offers something new in this cycle of education and is suitable for teachers.

Like any research that is associated with the methodological part, in this paper we will use the method of theoretical analysis, to have clearer results we will use tools and techniques such as the questionnaire for teachers, from which we will get the opinions and attitudes of them in relation to this Concept.

We will present the achieved results in a tabular way in order to have a clear picture about them and in this way we will notice how the new Concept will be a new opportunity for quality assurance in primary education in our country.

Keywords: Concept, reform, quality, success

ANALIZË E PROPOZIM KONCEPTIT TË RI PËR ARSIMIN FILLOR-NJË QASJE E RE NË KËTË CIKËL ARSIMI

Havushe Rexhepi

Universiteti i Tetovës, Fakulteti Pedagogjik, R.M.V, havushe.rexhepi@unite.edu.mk

Rabije Murati

Universiteti i Tetovës, Fakulteti Pedagogjik, R.M.V, rabije.murati@unite.edu.mk

Abstrakt: Arsimit sot është një problem shumë i rëndësishëm në të gjithë botën, pashtu edhe në vendin tonë, prandaj reformimi i tij është intencja kryesore e udhëheqësve të këtij digasteri.

Reformat në arsim kanë filluar të zbatohen që në vitet e mëparshme dhe vazhdojnë të jenë aktuale edhe sot sepse cilësia dhe suksesi varet nga këto reforma. Në lidhje me këtë problematikë është përpiluar edhe Koncepti për arsimin fillor, sipas të cilit ofrohet qasje bashkëkohore në mësim.

Ky punim ka për qëllim që të analizojmë Konceptin dhe të vërtetojmë sa në fakt përmbajtja e tij ofron diçka të re në këtë cikël të arsimit dhe është i përshtatshëm për mësimdhënësit.

Sikurse çdo hulumtim që shoqërohet me pjesën metodologjike, edhe në këtë punim do të shfrytëzojmë metodën e analizës teorike, për të pasur rezultate më të qarta do të shfrytëzojmë instrumente dhe teknika siç është pyetësori për mësimdhënësit, nga i cili do të marrim mendimet dhe qëndrimet e tyre në lidhje me këtë Koncept.

Rezultatet e arritura do t'i paraqesim në mënyrë tabelare për të pasur një figurë të qartë rreth tyre dhe në këtë mënyrë do të vërejmë sa Koncepti i ri do të jetë mundësi e re për sigurim të cilësisë në arsimin fillor në vendin tonë.

Fjalët kyçe: Koncept, reformë, cilësi, sukses

1. HYRJE

Arsimi si kategori e rëndësishme shoqërore duhet të jetë cilësor, efektiv dhe mbi të gjitha duhet të jetë reformues. Arsyeja për ndërmarrjen e reformave në arsim bëhet për shkak të pakënaqësisë nga gjendja aktuale dhe tendencat për një arsim më bashkëkohor, i cili do t'ju përgjigjet ndryshimeve që ndodhin në shoqëri.

Arsimi i sotëm ka detyrë të vështirë dhe me përgjegjësi, e ajo është të arsimoj nxënës që do të jenë të aftë të ndryshojnë gjendjen ekzistuese në shoqëri, duke iu përgjigjur sfidave të ndryshimeve bashkëkohore të shoqërisë dhe teknologjisë (Murati, R, 2016, fq.13).

Kur flasim për arsimin, me theks të veçantë kemi arsimin fillor i cili është shtylla kryesore për zhvillimin e individit, njeriut në përgjithësi dhe me të drejtë thuhet se çdo lëshim që bëhet në këtë cikël nuk mund të kompenzohet në asnjë nivel tjetër të arsimit.

Arsimi fillor është nënsistem i sistemit arsimor në vendin tonë i cili ka pësuar ndryshime dhe është në rrjedha të këtyre ndryshimeve. Në arsimin fillor duhet të vendosen baza të tilla në të cilat në mësimdhënie aksent më i vogël do të vendoset në mësimdhëniesin dhe mësimin e tij, kurse gjithnjë e më shumë do të praktikohet pajisja me dituri, aftësi dhe ndërtimit të qëndrimeve nga ana e nxënësve. Porosia kryesore është që fëmijët të mësojnë nga përvoja e tyre, t'u mundësohet që vet të eksperimentojnë, të përdorin mjete, të shfrytëzojnë simbole, të parashtrajnë pyetje dhe të arriturat e veta t'i krahasojnë me nxënësit tjerë (Murati, R, 2016, fq.27).

Kur flasim për ndryshime në sferën e arsimit në vendin tonë ato janë realizuar nëpër etapa, duke filluar me miratimin e Ligjit për arsimin fillor dhe të mesëm (shtator 1995), Modele, programe dhe dokumente strategjike për reformimin e sistemit edukativ-arsimor në Republikën e Maqedonisë në periudhën 1994-1998, Strategjia për zhvillimin e arsimit 2001-2010, Programi nacional për zhvillimin e arsimit në Republikën e Maqedonisë 2005-2015, Koncepti edukativ- arsimor për arsimin fillor 9 vjeçar, Strategjia e arsimit dhe plani i veprimit (periudhën 2018-2025) dhe në fund është Koncepti për arsimin fillor në vitin 2020.

Në përgatitjen e Konceptit të ri, Ministria e Arsimit dhe Shkencës u drejtua nga një hulumtim i kryer në nëntor të v.2020, me mbi 4168 mësimdhënës të cilët identifikuan nevojën për reformat arsimore dhe aspektet mbi të cilat ajo duhet të bazohet. Gjithashtu janë marrë parasysh analizat nga organizatat dhe institucionet ndërkombëtare të cilat tregojnë se janë të nevojshme reforma urgjente në arsim (mon.gov.mk.21.12.2020)

2. QASJA TEORIKE E PROBLEMIT

2.1. Bazat nismëtare

Arsimi fillor në Republikën e Maqedonisë së Veriut, tani për tani është niveli i parë i arsimit të detyrueshëm, i cili i përfshinë nxënësit e moshës 5 vjet e 8 muaj, përkatësisht 6 vjet deri në 14 vjet e 5 muaj, përkatësisht 15 vjet dhe është i organizuar në tre periudha: klasa I deri në të III, klasa e IV deri në të VI dhe klasa e VII deri në IX. Procesi edukativ-arsimor dhe veprimtaria e arsimit fillor rregullohen me Ligjin për Arsimin Fillor. Ligji aktual për arsimin fillor përcakton të drejtën për arsimim të çdo fëmije dhe përcakton parimet në bazë të të cilave zhvillohet arsimi fillor: zhvillimi i plotë i nxënësit, barazia, mundësia e arritjes, përfshirja dhe gjithpërfshirja, karakteri i përgjithshëm i arsimit fillor, sigurimi i arsimit cilësor dhe krahasueshmërisë ndërkombëtare të njohurive të nxënësve, multikulturalizmi dhe interkulturalizmi etj.

Kriza shëndetësore si pasojë e virusit COVID-19 ka pasur një ndikim të madh në sistemet e arsimit dhe trajnimit në Evropë dhe botë, me çrast arsimi është përballur me sfida të cilat mundësojnë mënyra të reja të mësimnxënies, mësimdhënies dhe komunikimit.

Në shtator të v.2020 Komisioni Evropian miratoi dy iniciativa që synojnë forcimin e kontributit të arsimit dhe trajnimit për rikuperimin e BE-së nga kriza dhe dhënien e ndihmës për të ndërtuar një Evropë “të gjelbër” dhe digjitale. Iniciativa ose nisma e parë është ringjallja e Fushës evropiane të arsimit me gjashtë dimensione: cilësi, përfshirje dhe barazi gjinore, tranzicione të gjelbra dhe digjitale, mësimdhënës, arsimi i lartë, një Evropë më e fortë në botë.

Nisma e dytë është Plani aksionar i arsimit digjital (2021- 2027), me iniciativë për arsim digjital me cilësi të lartë, gjithpërfshirës dhe të përbalueshëm në Evropë. Ky plan parashikon aksion për veprim dhe bashkëpunim më të fortë midis vendeve anëtarë në nivelin evropian (Propozim Koncepti për Arsimin Fillor).

Sfidat e arsimit fillor në vendin tonë

Nga viti 2007, me zbatimin e arsimit fillor nëntëvjeçar bëhen përpjekje për të pasur një arsim cilësor, modern, janë përgatitur programe mësimore që synojnë qëllimet, janë kryer trajnime për mësimdhënësit. Poashtu është hartuar Strategjia e arsimit për vitin 2018-2025 e cila përcakton aktivitetet që do të ndërmerren për të përmirësuar mësimdhënien dhe mësimnxënien (Po aty).

Një nga sfidat me të cilat përballet arsimi fillor është pajtueshmëria e nënsistemeve (arsimi parashkollor, fillor dhe i mesëm), i cili reflekton në cilësinë e arsimit. Gjatë aplikimit të arsimit fillor nëntëvjeçar, përmes bashkimit të vitit të detyrueshëm para fillimit të shkollës me tetë vitet e mëparshme të arsimit fillor, u bë vetëm një lidhje e pjesshme e nënsistemeve dhe u zvogëluar rëndësia e arsimit parashkollor. Kështu në këtë mënyrë përfshirja e fëmijëve parashkollor në kopshte u zvogëluar dhe kishte dallime në aspektin e modeleve didaktiko-metodologjike dhe qasjeve të aplikuara në punën me fëmijët në vitin para dhe pas shkollës, gjë që e bëri të vështirë përshtatjen e fëmijëve nga një nënsistem në tjetrin.

Gjithashtu, edhe arsimi fillor me atë të mesëm është dëmtuar, sepse ndryshimet në programet mësimore të aplikuara në vitin 2007 dhe të plotësuara në vitin 2013 nuk kishin ndryshime të përshtatshme në arsimin e mesëm, i cili paraqet një problem të veçantë, duke pas parasysh faktin

se arsimit i mesëm që nga viti 2001 nuk është reformuar.

Në arsimin fillor poashtu janë diskutabile edhe rezultatet e arritura të nxënësve në testimet ndërkombëtare, e që janë rezultate të pakënaqshme dhe jo cilësore.

Sipas hulumtimit të OECD, në v.2015 rezultati mesatar i 384 pikëve në shkencë krahasuar me pikët sipas OECD që janë 493, tregojnë se nxënësit në moshën 15 vjet në vendin tonë janë katër vjet pas kolegëve të tyre në vendet e OECD. Nxënësit nga Maqedonia e Veriut kanë rezultate më të ulëta edhe se nxënësit nga vendet fqinje, Shqipëria (427 pikë), Mali i Zi (411 pikë) dhe rezultate pak më të larta se nxënësit nga Kosova (378 pikë).

Në testimin e kryer të PISA në vitin 2018, ka një rritje të arritjeve në krahasim me vitin 2015, por përsëri arritjet e nxënësve në vendin tonë janë shumë të ulëta. Gjithashtu, sipas analizës krahasuese të OECD(2016), në Republikën e Maqedonisë së Veriut nxënësit nën moshën 14 vjeç marrin rreth 900 orë më pak mësim sesa mesatarja e nxënësve në vendet e OECD, kjo për shkak se në shkollat tona numër i madh i tyre punojnë me dy ndërrime.

Tekste shkollore jociësore, pajisje të dobëta të shkollave me burime mësimore, mungesa e mundësive të mësimdhënësve për zhvillim në karrierë, zhvillim jokonsistent profesional, probleme organizative dhe infrastrukture janë sfida shtesë me të cilat përballet arsimit fillor në vendin tonë

3. ÇFARË PËRMBAN KONCEPTI PËR ARSIMIN FILLOR

3.1. Gjithëpërfshirja, sensitiviteti gjinor, barazia dhe interkultura

Gjithëpërfshirja në arsim është segment shumë i rëndësishëm dhe është trajtuar në dokumentet e mëparshme ku theksohet: “Shkollat paraqesin mjedis gjithëpërfshirës për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore të cilëve u ofrohet mbështetje të plotë; është përmirësuar efikasiteti i financimit të proceseve të gjithëpërfshirjes dhe të nxënimit për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore; është përmirësuar ndërveprimi midis nxënësve që ndjekin mësimin në gjuhë të ndryshme etj”(Strategjia e arsimit dhe plani i veprimit për periudhën 2018-2025)

Poashtu, gjithëpërfshirja trajtohet edhe në Konceptin e ri ku përmendet se gjithëpërfshirja në arsimin fillor sigurohet në thelb për të gjithë fëmijët e moshës 6 vjeç deri në përfundimin e shkollës fillore. Shkollat fillore u mundësojnë nxënësve transport falas dhe adekuat për të ndjekur shkollën. Shkolla fillore punon ngushtë me qeverinë lokale dhe qendrore në sigurimin e informacionit dhe ndërmarrjen e masave në mënyrë që asnjë fëmijë të mos mbetet pa u përfshirë në këtë institucion. Rëndësi e posaçme u kushtohet grupeve që rrezikojnë të lënë shkollën herët.

Sensitiviteti gjinor është një segment tjetër i cili trajtohet në këtë Koncept, për të cilën gjë organizohen edhe seminare, ku në kuadër të trajnimit të mësimdhënësve për implementimin e kësaj reforme, temë kyçe është edhe barazia gjinore, interkultura etj.

3.2. Standardet nacionale

Me standardet nacionale për arsimin fillor janë përcaktuar kompetencat që nxënësit duhet të marrin në fund të arsimit fillor. Gjatë definimit apo përcaktimit të kompetencave të përfshira në Standardet nacionale u përdor Korniza Evropiane e Kualifikimeve, sipas së cilës kompetencat kryesore janë një kombinim i njohurive, aftësive dhe qëndrimeve. Në Standardet nacionale, njohuritë dhe aftësitë referohen si njohuri dhe aftësi të fituara dhe qëndrimet si vlera që nxënësi i kupton dhe i pranon si të vetat.

Të gjitha fushat e përfshira në Standardet nacionale konsiderohen njësoj të rëndësishme dhe të gjitha kompetencat shërbejnë për një jetë të suksesshme në shoqëri. Shumica e kompetencave që përcaktojnë fushën e Zhvillimit personal dhe social jo vetëm që synojnë komponentën edukative të arsimit, por gjithashtu ofrojnë një bazë për kompetencat që janë një parakusht i domosdoshëm për zhvillimin e kompetencave në shumë fusha të tjera.

3.3 Plani mësimor

Plani mësimor përmban lëndë të detyrueshme, lëndë zgjedhore dhe veprimtari të tjera të ofruara nga shkolla, të shpërndara sipas klasave dhe sipas numrit të orëve në javë dhe në vit.

Lëndët mësimore të detyrueshme i hasim në dy grupe: grupi A përbëhet nga lëndët Gjuhë maqedone/shqipe/turke/serbe/boshnjake, matematikë, shkenca natyrore, shkenca shoqërore dhe gjuhë angleze. Shkencat natyrore përfshinë përmbajtje që i përkasin biologjisë, gjeografisë fizike, kimisë dhe fizikës dhe vjen drejtpërdrejtë nga fusha e Shkencave natyrore dhe teknologjisë nga Standardet nacionale për arsimin fillor. Lënda e Shkencave shoqërore përfshinë përmbajtje që i përkasin historisë, gjeografisë shoqërore, arsimit qytetar, religjioneve, etikës dhe buron drejtpërdrejtë nga fusha e Kulturës demokratike dhe qytetërimi sipas Standardeve nacionale. Lëndët e sipërpërmendura janë të kyçura në të gjitha klasat e I deri IX, por me fond të ndryshëm të orëve. Në grupin tjetër të lëndëve (B), bëjnë pjesë lëndët që përfshijnë arsimin artistik, fizik dhe tekniko-teknologjik-informativ. Këto lëndë janë të pranishme në të gjitha klasat, por përveç arsimit fizik i cili është i pranishëm në të gjitha klasat me nga tre orë në javë, lëndët tjera të këtij grupi ndryshojnë nga një periudhë arsimit në tjetrën në numrin e orëve gjatë një jave. Në mesin e lëndëve të detyrueshme të dedikuara për nxënësit të cilët nuk e vijnë mësimin në gjuhën maqedonase, përfshihet gjuha maqedone e cila mësohet në periudhën e dytë dhe të tretë të arsimit fillor (IV-IX).

Lëndët zgjedhore- çdo shkollë ka të drejtë të ofroj lëndë zgjedhore varësisht nga interesat e nxënësve dhe mundësisë së kuadrit arsimor. Lëndët zgjedhore jepen në dy lista, njëra është me gjuhë të tjera dhe njëra është me lëndë të lira të cilat i ofron shkolla në përputhje me interesat e nxënësve dhe mundësitë të shkollës. Në gjuhët e huaja (gjuhë e huaj e dytë) bëjnë pjesë gjuha frenge, gjermane, italiane, ruse dhe gjuha shqipe për nxënësit të cilët mësojnë në gjuhë tjetër ndryshe nga gjuha shqipe. Kjo listë vlen për nxënësit nga klasa e VI-IX.

Përveç listës së gjuhëve kemi edhe listën tjetër të lëndëve zgjedhore e cila përbëhet nga katër kategori lëndësh:

- 1) Lëndë zgjedhore për thellimin e përmbytjes mësimore të lëndëve të detyrueshme (arsyetimi matematiko-logjik, programimi, piktura, historia e kultuës, edukimi seksual);
- 2) Lëndë zgjedhore që mbështesin interesat e nxënësve e që nuk janë pjesë e lëndëve mësimore (fotografi, kopshtari-hortikulturë, punëtori teatri, vallëzim, gatim, skulpturë, gdhendje, modelim);
- 3) Lëndë zgjedhore për të mbështetur zhvillimin personal dhe shoqëror të nxënësve (arsimi për shkathtësi jetësore, punëtori multikulturore);
- 4) Lëndë zgjedhore me karakter sportiv-rekreativ (futboll, basketboll, hendboll, volejball, ping-pong, alpinizëm, çiklizëm).

Një nga qëllimet e rëndësishme të lëndëve zgjedhor të lira është t'u jap nxënësve mundësinë për të zbuluar "pikat e forta" dhe aftësitë e tyre që mund të mos jenë të dukshme në orët e tjera, në këtë mënyrë të afirmohen para shokëve të klasës.

Organizimi i mësimi sipas planit mësimor- këtu vlen të përmendim se nxënësit në shkollë nuk duhet të qëndrojnë vetëm sipas orarit të caktuar në klasë por se duhet të qëndrojnë nga klasa e I-rë deri në të V-ën pesë orë në ditë, me çka do të realizojnë edhe aktivitete të tjera si shoqërim përmes lojës dhe veprime të tjera argëtuese.

Nxënësit nga klasa e VI-IX qëndrojnë në shkollë nga 6 orë në ditë, nga të cilat 4-4,5 orë janë për orë mësimore dhe koha e mbetur për aktivitete të tjera.

Organizimi i mësimdhënies në funksion të planit mësimor imponon një rol tjetër të mësimdhënësve i cili reflektohet edhe në kohën që duhet të kalojë në shkollë. Mësimdhënësit nuk janë vetëm ligjërues të një lënde mësimore të përshtatshme, por duhet të jenë edhe zbatues të lëndëve zgjedhore dhe për të njejtat nuk duhet të jetë i diplomuar domosdoshmërisht, por nga aftësitë e tyre të fituara në mënyrë informale (gatimi, fotografia, ndihma e parë dhe mbrojtja) në mënyrë që të jenë në gjendje të përmbushin të gjitha detyrat dhe të qëndrojnë 6 orë në ditë.

3.4 Programet mësimore

Programet mësimore për lëndët e detyrueshme dhe zgjedhore në fushën e gjuhës përgatiten në nivel kombëtar, nga ekipe profesionale. Programet mësimore për lëndët zgjedhore të lira përgatiten nga ekip mësimdhënësish brenda shkollës. Këto programe mësimore zhvillohen në përputhje me udhëzimet e përgjithshme të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit, bazuar në parimet e vendosura për zhvillimin e programeve mësimore. Programi mësimor ofron udhëzime dhe shembuj të veprimtarive që mësimdhënësi mund t'i zbatojë për të arritur rezultate të të nxënësve, sepse rezultatet janë thelbësore për programet mësimore, por më e rëndësishmja është se i japin liri për të përdorur dhe krijuar një larmi aktivitete dhe materiale për ineteresat dhe moshën e nxënësve.

Programet mësimore zhvillohen në atë mënyrë që të jenë fleksibil, përkatësisht realizimi i tyre të përshtatet në grupe nxënësish ose nxënës individual, të cilët për arsye të caktuara nuk kanë mundur t'i ndjekin mësimet në mënyrë të plotë. Fleksibiliteti i programeve mësimore mundëson rregullimin e kushteve për mësimdhënie.

3.5 Mësimdhënia dhe mësimnxënia

Planifikimi i mësimdhënies është një parakusht për përgatitjen, organizimin dhe zbatimin cilësor, të suksesshëm dhe efikas të procesit mësimor. Ai bazohet në programin mësimor dhe merr parasysh karakteristikat e nxënësve, kushtet dhe mjetet të cilat i ka në dispozicion mësimdhënësi dhe shkolla. Kur bëhet fjalë për periudhën e parë të arsimit fillor (klasa I-III), mësimdhënësit kanë liri të planifikojnë në mënyrë që të sigurojnë realizimin e mësimdhënies në tëtrësi, pa ndarje të dukshme sipas lëndëve dhe pa një kohëzgjatje të përcaktuar të orëve. Pritet që t'i mundësojë mësimdhënësit të rregullojnë mësimin me moshën, nevojat, ritmin e përparimit të nxënësve me të cilët punon. .

Projektet mund të jenë të bazuara në hulumtime, për të inkurajuar nxënësit të marrin rolin e studiuesve dhe pak a shumë në mënyrë autonome për të zgjedhur një problem dhe për të kryer kërkime në mënyrë që ata të kuptojnë më lehtë dhe më thellë fenomenet që mësojnë dhe lidhin përmbytjen që e mësojnë me realitetin. Përfshirja në kërkime kërkon që nxënësit të formulojnë një problem dhe hipotezë, të vendosin se cilat burime u duhen, të mbledhin të dhëna, të përpunojnë të dhëna, të nxjerrin konkluzione dhe të përgatisin një raport.

Mësimi digjital ose përdorimi i informacionit dhe teknologjisë kompjuterike në arsim modernizon mësimdhënien, forcon kompetencat për të mësuarit gjatë gjithë jetës, zgjeron gamën e burimeve mësimore. Infrastruktura e përshtatshme e shkollës dhe klasave është e nevojshme për realizimin e mësimdhënies së tillë, internet i siguar, pajisje me kompjuterë dhe mjete të tjera elektronike përkatëse për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Aplikimi i

mjeteve digjitale që ndjekin praktikat më të mira lehtëson mësimdhënien dhe të mësuarit sepse bazohet në metoda inovative që janë më afër interesave të nxënësve dhe kërkesave të jetës moderne.

Platformat dhe portalet e internetit në arsim (të tilla si Platforma nacionale e prezentuar në vitin 2020) mundësojnë përdorimin e përbajtjes elektronike dhe mjeteve digjitale për të pasuruar mësimin në klasë por edhe për të realizuar mësimin në distancë i cili realizohet si pasojë e sëmundjeve të ndryshme, katastrofave të mëdha natyrore.

Përshtatja e mësimin në përputhje me nevojat dhe mundësitë e nxënësve është segment shumë i rëndësishëm në këtë koncept. Kjo nënkupton që mësimdhënësi të jetë në gjendje të identifikojë aftësitë e nxënësve dhe në përputhje me rrethanat të planifikojë një qasje të individualizuar dhe mësimdhënie të diferencuar.

3.6 Mjetet mësimore

Mjetet mësimore janë të domosdoshme për të siguruar një arsim cilësor që bazohet në mësimdhënie ndërvepruese dhe të mësuarit me përvojë duke marrë parasysh nevojat e nxënësve në kushte moderne. Mësimdhënësit në arsimin fillor kanë të drejtë të zgjedhin materiale të nevojshme për nxënësit e tyre me qëllim që të arrijnë rezultatet e pritura të përcaktuara me plan-program.

Të gjitha lëndët e detyrueshme nga grupi A dhe të gjitha lëndët me zgjedhje në fushën e gjuhëve të huaja janë të mbuluara me tekste cilësore që janë plotësisht të harmonizuara me programin mësimor si dhe me nevojat dhe interesat e nxënësve. Tendenca është që format klasike të librave shkollorë të zëvendësohen gradualisht nga versione digjitaleqë e bëjnë më të lehtë për mësimdhënësin të realizojnë mësimin dhe nxënësit të arrijnë rezultate të dëshiruara. Tekstet digjitale integrojnë TIK-un në mësimdhënie dhe kështu modernizojnë mësimdhënien. Mundësia për t'i angazhuar nxënësit në një sërë aktivitete mësimore i bën librat shkollorë digjital një mjet mësimor interaktiv, tërheqës dhe stimulues.

Mjetet mësimore dhe mjetet ndihmëse shërbejnë që ta rrisin aktivitetin dhe motivimin nxënësve, fokusin në mësim dhe të kontribuojë për zhvillimin e aftësive funksionale të nxënësit. Për këtë qëllim, klasat në shkollë janë të pajisura me kompjuterë, printerë, projektorë dhe pajisje tjera.

3.7 Siguria e cilësisë

Një parakusht për arsimin cilësor është një sistem arsimor koherent, me kushtet e parashikuara për zhvillimin e suksesshëm të të gjitha proceseve në arsim.

Pjesëmarrja në teste ndërkombëtare i siguron vendit mbikqyrje në arritjet e nxënësve tanë krahasuar me nivelet e arritjeve të përcaktuara ndërkombëtarisht. Vendi ynë rregullisht merr pjesë në matjet e shkrim-leximit matematikor dhe shkrim-leximit në shkencat natyrore (TIMSS), në matjet e kuptuarit të leximit (PIRLS) dhe në matjet që matin aftësitë e nxënësve në moshën 15 vjeçare për të përdorur njohuritë dhe aftësitë e leximit, matematikë dhe shkencat natyrore (PISA). Shteti mund të përfshihet edhe në matje tjera ndërkombëtare si ato në fushën e arsimit qytetar (CIVED) ose shkrim-leximit të informatikës (ICILS).

3.8 Kuadri arsimor, bashkëpunëtorët profesional dhe drejtorët

Ciësia e realizimit të procesit arsimor në shkolla varet nga kompetencat e të gjithë stafit të inkuadruar në shkolla, përfshirë bashkëpunëtorët profesional dhe drejtorin.

Organizimi i punës, motivimi i mësimdhënësve, klima e përgjithshme në shkollë dhe reputacioni që gëzon shkolla në mjedis varet nga drejtori i shkollës. Për kryerjen me sukses të detyrës së drejtorit, ato përgatiten përmes trajnimit specifik dhe dhënies së një provimi për drejtor, që dëshmon se ata posedojnë kompetencat e nevojshme profesionale për ta ushtruar rolin e drejtorit. Në manifestimin e kompetencave të tyre në praktikë, drejtorët karakterizohen nga iniciativa, profesionalizmi, angazhimi për zhvillimin e shkollës, përgjegjësia dhe etika e punës.

Zhvillimi profesional mund të lind nga nevojat e shkollës të identifikuar gjatë vetëvlerësimit ose vlerësimit integral nën ndikimin e këshilltarëve përgjegjës për mbështetjen e mësimdhënësve dhe mësimdhënies. Mësimdhënësit mund të vetëtrajtohen në mënyrë profesionale, përmes bashkëpunimit me kolegët brenda shkollës ose brenda bashkëpunimit ndërshkollor (në nivel nacional dhe ndërkombëtar). Bashkëpunimi ndërmjet mësimdhënësve është poashtu një faktor shumë i rëndësishëm për të siguruar cilësi në mësim. Zhvillimi i karrierës së mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional bazohet në standardet profesionale që arrihen dhe provohen përmes zhvillimit të vazhdueshëm profesional, duke fituar titull shtesë akademike ose duke ndjekur trajnime të ndryshme profesionale.

Sistemi u mundëson mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional të avancojnë karrierën e tyre në dy nivele: mentor dhe këshilltar. Për të arritur në nivel të caktuar, punonjësit arsimor duhet t'i plotësojnë kushtet e duhura profesionale në fusha të caktuara, që të marrin titujt e paraparë.

4. KORNIZA METODOLOGJIKE

1. Lënda e kërkimit

Lënda e kërkimit në këtë hulumtim është analiza e Propozim konceptit për arsimin fillor, një dokument i cili synon reforma në këtë cikël arsimi, duke pas parasysh rëndësinë që ka arsimi fillor në aftësimin e njeriut për jetë dhe veprim të pavarur në shoqëri.

2. Qëllimi i hulumtimit

Meqë e paraqitëm arsimin si një aspekt i rëndësishëm për shoqërinë, atëherë qëllimi ynë në këtë hulumtim është të analizojmë, të marrim mendime nga mësimdhënës në lidhje me këtë dokument reformues për arsimin fillor.

3. Detyrat e hulumtimit

Për të hulumtuar efektin e Konceptit dhe reagimet e mësimdhënësve nga kjo qasje e re që do të ndikon në cilësinë e arsimit, duhet të realizojmë disa detyra në lidhje me këto çështje, siç janë:

- Leximi i Propozim Konceptit për Arsimin Fillor,
- përshkrimi i tij në aspektin teorik,
- realizimi i anketës me mësimdhënës,
- interpretimi i rezultateve nga hulumtimi.

4. Metodrat

- metoda e analizës teorike,
- metoda deskriptive,
- metoda e anketimit.

5. Teknika

Për të arritur deri te qëllimi i hulumtimit do të realizojmë anketën me mësimdhënës të arsimit fillor me anë të së cilës do të marrim mendime, ide, sugjerime për Konceptin e paraparë, sa do të jetë i suksesshëm implementimi i tij në sistemin tonë arsimor.

6. Hipoteza

Hipoteza jonë kryesore në këtë hulumtim është: Supozojmë se Koncepti i ri për arsimin fillor do të jetë një hap pozitiv për një qasje të re të arsimit fillor në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

H1. Koncepti për arsimin fillor është i mirëpritur nga kuadri arsimor në shkollat tona.

H2. Koncepti për arsimin fillor do të ndikon në cilësinë e arsimit.

H3. Shkollat tona i plotësojnë kushtet për të zbatuar këtë reformë.

7. Variablat

Variabla e varur në këtë hulumtim është zbatimi i Konceptit për arsimin fillor kurse variabla e pavarur është efekti i zbatimit të tij në vendin tonë, predispozitat që ekzistojnë në shkollat, mundësitë për implementimin e tij, duke marrë parasysh se mund të hasim mendime dhe kritika në këtë drejtim.


5. ANALIZA DHE INTERPRETIMI I REZULTATEVE

Në fillim vlen të theksojmë se kur flasim për ndonjë reformë në çfarëdo sferë, menjëherë na asocon në cilësi dhe sukses, poashtu edhe në arsim ndodh një gjë e tillë, siç është rasti me Konceptin e ri për arsimin fillor. Shumë mësimdhënës janë deklaruar se arsimi në vendin tonë ka nevojë për reformim prandaj është marrë iniciativa për përpilimin e një dokumenti reformues.

Siç e kemi përmendur më lartë se Koncepti për arsimin fillor është dokument i cili e përfshin ciklin e ulët të arsimit fillor, pra klasën e I-rë dhe të IV-t, në të cilën përmenden disa ndryshime të cilat duhet të ndodhin në këtë periudhë të shkollës fillore në vendin tonë, pra në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Rezultatet nga hulumtimi i realizuar na tregojnë qartë sa në të vërtetë ky dokument do të jetë cilësor ose më mirë të themi sa mësimdhënësit janë të mendimit për cilësinë e tij dhe ndryshimet pozitive që mund të sjell në shkollat tona.

Për të vërtetuar këtë do të japim pasqyrimin e disa pyetjeve dhe rezultatet e nxjerra të cilat edhe përkasin me hipotezat tona të parashtruara.

Mosha e mësimdhënësve të cilët janë përfshirë në këtë hulumtim varion, por përqindja më e madhe e tyre është rreth 31-40 vjet, ose 38,1%.




Përvojën e mësimdhënësve e kemi shpërndarë në disa vite, kurse përqindja më e madhe e mësimdhënësve në këtë hulumtim është 11-20 vite përvojë punë, konkretisht 46,3%.

Gjinia femërore është ajo që dominon në këtë hulumtim, ku gjithësej nga 60 mësimdhënës, 57,1% e tyre është e gjinisë femërore dhe 42,9% janë të gjinisë mashkullore.

Kur përmendëm rëndësinë e reformave në arsim dhe nevojën për implementimin e tyre, kemi pyetjen e parashtruar në lidhje me këtë, siç është: Reformat në arsim në vendin tonë janë të nevojshme, dhe nga variantet e përgjigjeve siç janë:

- Pajtohem
- Pjesërisht pajtohem
- Aspak nuk pajtohem,


si rrjedhojë kemi këtë grafikun të rezultateve:



Në këtë grafikun shohim se 45, 2% e mësimdhënësve janë të mendimit se reformat në arsim janë të nevojshme dhe se ato duhet të miratohen dhe të njejat të zbatohen.

Koncepti për arsimin fillor do të ndikon në cilësinë e arsimit është një hipotezë e parashtruar në këtë analizë, megjithatë rezultatet na dëshmuar se mësimdhënësit mendojnë se pjesërisht kjo reformë do të ndikon në cilësinë e arsimit. Këtë mund ta shohim në paraqitjen e rradhës: Ky dokument a do të ndikon në rritjen e cilësisë në arsim në vendin tonë?, dhe nga përgjigjet e parashtruara:


- Ndikon
- Pjesërisht do të ndikon
- Aspak nuk do të ndikon, kemi këtë pasqyrë:



Në këtë grafikon shohim se mësimdhënësit pjesërisht mendojnë se ky dokument do të ndikon në rritjen e cilësisë në arsim ose 66,7% e tyre, 14,3% e tyre mendojnë se ndikon dhe 19% e tyre mendojnë se aspak nuk do të ndikon.


Nëse duhet të bëjmë ndryshime në aspektin cilësor në arsim, atëherë ndryshimet nuk duhet të jenë vetëm në aspektin teorik, por ato duhet të gjejnë zbatim edhe në praktik. Që të ndodh një gjë e tillë detyrimisht politika arsimore, konkretisht Ministria e arsimit duhet që në shkolla të krijoj kushte dhe t'ua bëjë të mundur udhëheqësve të shkollave, mësimdhënëseve që të zbatojnë ato ndryshime dhe mundësi të reja me qëllim që reforma të ketë sukses dhe të sjell rezultate.

Në lidhje me këtë që përmendëm theksoj edhe hipotezën e rradhës të cilën e parashtruam e që thotë: *Shkollat tona i plotësojnë kushtet për të zbatuar këtë reformë*, mirëpo në analizë dhe hulumtim të dhënat flasin ndryshe, e këtë e dëshmon pyetja e rradhës e anketës: *Shkollat tona a posedojnë kushte për zbatimin e këtij koncepti?*, dhe nga përgjigjet e parashtruara kemi këtë paraqitje:



Kjo na dëshmon se për të realizuar Konceptin duhet që të ekzistojnë kushtet në shkollat tona, infrastrukturë e mjaftueshme, gjë e cila mungon. Këtë e shohim në grafikonin e radhës ku përqindja më e madhe e mësimdhënëseve janë përgjigjur se në shkollat tona pjesërisht ekzistojnë kushtet për të zbatuar Konceptin e ri.

Për zbatimin e suksesshëm të kësaj reforme duhet të realizohen trajnime, e me këtë janë të mendimit edhe mësimdhënësit, kjo pasqyrohet në grafikonin e radhës:



Grafikoni në fjalë na tregon se 70,7% e mësimdhënëseve deklarohen se kanë nevojë për trajnime dhe se duhet të realizohen, 19,5% janë të mendimit se janë të rëndësishme deri diku, kurse 9,8% thonë se nuk duhet.

6. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Në bazë të hulumtimit empirik dhe rezultateve të fituara nga ky hulumtim mund të vijmë në disa përfundime:- Koncepti për arsimin fillor si dokument i rëndësishëm për cilësinë në arsim edhe pse është përpiluar nga profesionistë të ndryshëm, megjithatë mësimdhënësit janë të mendimit se ky koncept nuk do të jetë efikas sepse ekzistojnë faktorë të ndryshëm të cilët e pamundësojnë një gjë të tillë.

Të mësuarit e nxënësve përmes platformës digjitale parashihet në këtë dokument, mirëpo nuk mund të themi se vet fakti se procesi mësimor digjitalizohet dhe sukcesi vjen vetvetiu, këtë e vërejmë në vlersimet që kanë dhënë mësimdhënësit, ku shumica e tyre ose përqindja më e madhe është përcaktuar për shkallën ose numrin 3, nga 1-5. Një shkollë është cilësore dhe efektive nëse në të luftohet diskriminimi gjinor, racor, kombëtar, ku këtë fenomen e vërejmë dhe është aktuale në tekste mësimore, mirëpo ky dokument parasheh që të eliminohet kjo dukuri, megjithatë

mësimdhënësit shprehen skeptik në këtë drejtim, ku përqindja më e madhe e tyre janë shprehur se pjesërisht do të eliminohet kjo dukuri.

Që realizimi i Konceptit të jetë në nivelin e duhur duhet të organizohen edhe trajnime për mësimdhënësit, të cilat kanë filluar në shkollat tona, këto janë të domosdoshme sepse mësimdhënësit përgatiten paraprakisht për implementimin efikas të tij, këtë gjë e dëshmon edhe përgjigja e mësimdhënësve ose përqindja e tyre e cila shënon 70,7% e mësimdhënësve të cilët janë deklaruar se këto trajnime janë të nevojshme.

Në dokumentin e parashtruar shihen shumë segmente të rëndësishme që trajtohen dhe duhet të realizohen, siç janë: ndryshimet në planet mësimore, mjetet mësimore, qëndrimi i zgjatuar i nxënësve dhe mësuesve në shkolla, përsosja profesionale e mësimdhënësve, zhvillimi i karrierës së tyre, bashkëpunimi me prindërit. Edhe pse disa prej këtyre janë çështje të cilat kanë qenë aktuale, megjithatë trajtohen dhe përmenden në këtë dokument si pasojë e lëshimeve ose neglizhencës së tyre.

Që arsimit në vendin tonë të ec përpara dhe të jetë në hap me arsimin e vendeve të zhvilluara, me trendet bashkëkohore në arsim duhet të punohet shumë duke filluar nga udhëheqësit më të lartë të këtij sektori, deri te nxënësit të cilët janë ata me të cilët dhe për të cilët realizohet procesi edukativ-arsimor.

Nga gjithë ky përshkrim dhe analizë përfundojmë se mësimdhënësit janë paraqitur skeptik se kjo reformë do të ndikoj në cilësinë e arsimit megjithatë, përsëri pasi të fillojë të realizohet duhet të bëhet një hulumtim për të parë ecurinë e saj dhe ndryshimet që mund të shkaktojë kjo.

BIBLIOGRAFIA

Murati, R. (2016). Demokratizimi i sistemit edukativ-arsimor në Republikën e Maqedonisë, Tetovë

Murati, R. (2019). Mësuesi bashkëkohor dhe arsimit cilësor, Tetovë

Murati, Xh. (2014). Tendencat evropiane në arsim,

Murati, Xh. (2018). Zhvillimi profesional si koncept bashkëkohor demokratik,

Programi nacional për zhvillimin e arsimit në Republikën e Maqedonisë 2005-2015,

Strategjia e arsimit dhe plani i veprimit për periudhën 2018-2025

Propozim Koncepti për arsimin fillor